




SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË
"KEKA – MED"
KLINË



Adresa: Rr. "Sadik Rama", p.n. – Klinë, 32.000 / Email: shmpkekamed@gmail.com / Kontakt: +383(0) 44/48 663001

Nr. prot: 01- 1498 /26

Më: 07 / 07/ 2026

Mbështetur në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, Ligjin për Arsim dhe Aftësim Profesional Nr. 04/L-138, dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 Numri Maksimal i Nxënësve për Klasë dhe Raporti Mësimdhënës Nxënës, si dhe vendimit të Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me Nr. 01/465, datë 29.05.2026, Shkolla e Mesme e Mjekësisë "KEKA-MED", shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të në Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) "KEKA-MED" në Klinë

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në IAAP në vitin shkollorë 2026/2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit të cilët kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në IAAP, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulet (6-9)
- Ekstraktin e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve në IAAP për vitin shkollor 2026/27, bëhet nga

Dt., 07.07.2026 deri 10.07.2026, në objektin e Shkollës së Mesme të Mjekësisë "KEKA-MED" në Klinë, duke filluar nga ora 8:00-16:00.

Ndërsa konkursi plotësues për vende të lira do të shpallet me 18.08.2026. Dorëzimi i dokumenteve më 19, 20 dhe 21 Gusht 2026. Shpallja e rezultateve më 21.08.2026.



SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË
"KEKA – MED"
KLINË

Adresa: Rr."Sadik Rama", p.n. – Klinë, 32.000 / Email: shmpkekamed@gmail.com / Kontakt: +383(0) 44/48 663001

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në objektin e shkollës më datën: 13.07.2026.
Kthimi i dokumenteve për nxënësit të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës: 14.07.2026.
Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve. Ankesat parashtrihen në drejtorinë e shkollës.

Kriteret për Regjistrim

Nxënësi për regjistrim për klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriterë:

1	Suksesi nga shkollimi i obliguar	40 %	40 pikë
2	Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar	20%	20 pikë
3	Numri i pikëve nga testi	40%	40 Pikë

Nxënësi maksimalisht duhet t'i fitojë (100%) 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për Shkollën e Mesme të Mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga këto lëndë (se pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat 6-9, pastaj mesatarja e mesatarëve të atyre lëndëve).

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$- \text{Suksesi (kl. 6+kl.7+kl.8+kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

Mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = pikë max.

- **Lëndët me prioritet më sukses sipas profileve në IAAP**
Shëndetësi: Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe Letërsi
IT me Elektronikë:
Matematikë, Fizikë, TIK, Gjuhë Shqipe dhe Letërsi

Kriteri i suksesit (notat) në lëndët prioritare për drejtimin shëndetësi:

IAAP – mesatarja e lëndëve: Fizike, Kimi, Biologji dhe Gjuhë shqipe dhe Letërsi, së paku duhet të jetë katër (4), si dhe 40% të pikëve të lëndëve prioritare në test (10 pikë nga lëndët: Fizik, Kimi, Biologji dhe Gjuhë shqipe dhe Letërsi).

$$\text{Mesatarja (Kimi)} + \text{mesatarja (Biologji)} + \text{mesatarja (Fizik)} + \text{mesatarja (Gjuhë shqipe dhe Letërsi)} = 4$$




SHKOLLA E MESME E MJEKËSISË
"KEKA - MED"
KLINË

Adresa: Rr."Sadik Rama", p.n. – Klinë, 32.000 / Email: shmpkekamed@gmail.com / Kontakt: +383(0) 44/48 663001

**Planifikimi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në IAAP "KEKA-MED" në
Klinë, viti shkollor 2026-2027**

Planifikimi Viti shkollor 2026-2027						
Nr	Shkolla	Drejtimi	Profili	Paralele	Nxënës	Gjithsej
1.	SHMM "KEKA-MED"	Mjekësi	Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	2	24	48
2.	SHMM "KEKA-MED"		Teknik i Farmacisë	2	24	48
3.	SHMM "KEKA-MED"		Asistent Dentar	1	20	20
4.	SHMM "KEKA-MED"		Teknik i Laboratorit Mjekësor	2	24	48
5	SHMM "KEKA-MED"	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimim	IT me Elektronikë	2	24	48
Totali:				9	116	212



Drejtori i shkollës:
Msc: Ilir Keka